



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:084392

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04977958

PPP.nr.636/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit A . B . nga Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e paraqitur nga debitori, jashtë seance, më datë 27.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit A . B . nga Komuna e Fushë Kosovës, i datës 15.04.2021, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.155/2021, të datës 30.03.2021, të Përmbaruesit D . G . nga Prishtina, dhe

II. SHFUQIZOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.155/2021, i datës 30.03.2021, i Përmbaruesit Privat D . G . nga Prishtina.

A r s y e t i m i

Përmbaruesi Privat D . G . nga Prishtina, me datë 30.03.2021, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.155/2021, sipas propozimit për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, kundër debitorit A . B . , për shumën prej 223.5 euro, për borxhin e mbledhur për periudhën 01.01.2016 deri 28.02.2021, me kamatëvonesë prej 8% nga dita e lejimit të përmbarimit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, pas pranimit të urdhrin përmbarimor, brenda afatit ligjor, më datë 15.04.2021 ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar kërkesën e kreditorit si të pabazuar, duke theksuar se kërkesa e kreditorit ndaj debitorit është e parashkruar për priudhën 01.01.2009 e deri më 29.12.2015, në shumë prej 230 euro si borxh i mbetur, ndërsa borxhin për vitet e mëvonshme 2015-2021 debitori e ka përmblusur në tërësi. Kështu ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet prapësimi i tij dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor i lejuar nga përmbaruesi privat i lartcekur.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se debitori pretendimin kryesor në prapësim e ka pasur institutin e parashkrimit, por sipas kreditorit ky institut në këtë rast nuk vlen sepse debitori vazhdimisht ka bërë pagesa duke e pranuar kështu borxhin dhe duke e ndërprerë parashkrimin. Kështu ka kërkuar nga gjykata që urdhri i përmbaruesit të lihet në fuqi, ndërsa prapësimi i debitorit të refuzohet.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve gjeti se prapësimi i debitorit i datës 15.04.2021, është i bazuar, pasi që kredia e përcaktuar në dokumentin e besueshëm mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor është përmbushur në tërësi nga debitori, ndërsa për periudhën e mëhershme për të cilën kreditori kërkon përmbushjen, i njëjti nuk ka ofruar prova për të vërtetuar ekzistimin e këtij borxhi. Gjykata deri te ky vlerësim erdhi në bazë të kartelës së klientit sipas të cilës është lëshuar urdhri përmbarimor, ku shihet se debitori, për periudhën e cila figuron në kartelë, dhe atë janar 2018 – shkurt 2021 i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij me rregull. Kreditori në propozimin për përmbarim, borxhin nga debitori e ka kërkuar për periudhën 01.01.2016 e deri 28.02.2021, mirëpo në mbështetje të kësaj kërkesë, si provë ka bashkëngjitur dokumentin e besueshëm – kartelën e konsumatorit, në të cilën nuk figuron borxhi i kreditorit nga periudha e kërkuar, pra nga data 01.01.2016, por nga data 29.01.2018, e ku siç u cek më lart, nga kjo datë e tutje me kartelën e konsumatorit vërtetohet se debitori vazhdimisht e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, ndërsa për periudhën para muajit janar të vitit 2018 kreditori, siç u cek më lart, nuk ka ofruar prova për ta mbështetur ekzistimin e kredisë së tillë.

Me nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) është paraparë se “1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”. Me nenin 29 të LPP-së është paraparë se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, vërtetohet se dokumenti i besueshëm në bazë të të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor nuk ka tipare të përmbarueshmërisë për shumën e kërkuar para datës 29.01.2018, pasi që kjo shumë nuk dihet se si ka ardhur, në të nuk figurojnë muajt të cilët i ka cekur kreditori në propozim për përmbarim, dhe rrjedhimisht kjo e bënë dokumentin e besueshëm të papërshtatshëm për përmbarim.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.636/21, datë 27.11.2023

Gjyqtari,
Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.